



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 39
Prishtinë, më 17 nëntor 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 17 NËNTOR 2011**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 79 deputetë. Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 8 nëntor 2011,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012,
5. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për mbeturinat,
6. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Nazane Breca, Emilija Rexhepi, Halit Krasniqi Goran Maksimoviq, Lutfi Haziri, Arsim Bajrami, Vesimir Saviq, Xhevahire Izmaqi dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Agim Kuleta, parashtroi pyetje për ministrin Bedri Hamza lidhur me uljen e mundshme të tatimit mbi vlerën e shtuar për produktet bujqësore dhe afatin kohor lidhur me këtë çështje.

Ministri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetit Agim Kuleta.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 8 nëntor 2011

Kuvendi miratoi pa vërejtje Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 8 nëntor 2011.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012

Kryetari ftoi kryeministrin Hashim Thaçi, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Hashim Thaçi, fillimisht tha se sot është një ditë e rëndësishme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pasi që sot Kuvendi ka në rend dite shqyrtimin dhe miratimin e Projektligjit për Buxhetin e Kosovës, për vitin 2012.

Buxheti të cilën do ta miratojmë sot, është shumë domethënëse për shumë arsye. Ky buxhet i sukseseve tona, është buxhet i premtimeve të mbajtura dhe, mbi të gjitha, buxhet i dinjitetit të shtetit tonë demokratik dhe të qytetarëve tanë, i cili vjen si rezultat i punës dhe përpjekjeve të palodhshme të institucioneve tona për të ndërtuar një buxhet që garanton zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies së qytetarëve tanë.

Më tej, kryeministri Thaçi u fokusua në përkushtimin e Qeverisë të cilën e udhëheq ai, për të punuar për të mirën e të gjithë qytetarëve tanë, pa dallime etnike, fetare, regjionale dhe në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Si veçori të këtij Projekt-buxheti ai theksoi faktin se në të reflektohen plotësisht politikat prioritare të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe, si i tillë, është i bazuar në politika mirë qeverisëse dhe sidomos në planin dhe vizionin për zhvillimin ekonomik të vendit, i cili reflekton më së miri angazhimin tonë për të ecur përpara në gjithë sektorët strategjikë, të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm për investime të huaja.

Më pas, kryeministri vuri në pah edhe disa sektorë tjerë për të cilët parashihet rritje e financimeve, siç janë ai i bujqësisë, projektet kapitale, duke përfshirë këtu edhe projektin

më madhor, rrugën Morinë-Merdarë, në fushën e infrastrukturës, të arsimit, shëndetësisë, telekomunikacionit, energjetikës etj., për të konstatuar se në vitin 2012 Projektbuxheti parasheh rritje ekonomike 5%.

Kryeministri, në fund falënderoi për bashkëpunimin e treguar dhe shfaqti bindjen se të gjitha kritikët, vërejtjet, sugjerimet që do të dalin nga ky shqyrtim, do të jenë në funksion të rregullimit sa më të mirë të këtij Projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin e tij.

Më pas, **kryetari** ftoi Ministrin e Financave që në emër të Qeverisë ta arsyetojë këtë projektligj.

Ministri **Bedri Hamza**, në fillim të fjalës së tij falënderoi të gjitha grupet parlamentare për mundësinë që i është dhënë për të diskutuar Projektbuxhetin për vitin 2012.

Ai tha se ky Projektligj është në harmoni të plotë me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, neni 20 dhe 21, dhe si i tillë është projektbuxhet në të cilin kanë marrë pjesë të gjitha organizatat buxhetore, duke përfshirë edhe nivelin lokal dhe qendror dhe është harmonizuar edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Më tej, ai paraqiti ecurinë e disa indikatorëve makro-ekonomikë për vitin 2011. Ministria e Financave, qysh në fillim të vitit ka projektuar që rritja ekonomike për vitin 2011, për Kosovën do të jetë 5.3%, fakt ky të cilin e konfirmojnë edhe institucionet më kredibile të kësaj fushe, siç është Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Kjo rritje në raport me vendet e rajonit paraqet rritjen më të madhe, theksoi ministri.

Performanca a e mirë e të hyrave gjatë këtij viti, ka mundësuar që ne t'i mbulojmë shpenzimet e parapara me buxhetin për vitin 2011. Kjo performacë e të hyrave, që ne vlerësojmë se do të jetë diku 200 milionë më tepër, në krahasim me vitin paraprak, ka mundësuar që të mbulohet rritja e pagave, kur dihet që kemi pasur një rritje të pagave, për të gjitha kategoritë e të punësuarve të cilët financohen nga buxheti i Kosovës.

Në vazhdim, ai u fokusua në elaborimin e disa parametrave makro-ekonomikë sa i përket Projekt-buxhetit për vitin 2012, për të cilat tha se rritja ekonomike parashihet se do të jetë 5%, deficitit buxhetor që pritet të jetë diku rreth 3%, të hyrat e planifikuara për vitin e ardhshëm janë në lartësi prej 1 miliard e 361 milionë, prej të cilave 860 milion euro janë të parapara që të mbledhen nga doganat e Kosovës, 285 milionë janë nga Administrata Tatimore e Kosovës, 168 milionë janë të hyra vetanake të nivelit qendror dhe të nivelit komunal, 35 milionë euro nga dividendat e PTK-së, rreth 30 milionë euro grante nga Banka Botërore.

Më pas, ai foli në mënyrë të hollësishme për të dalurat buxhetore që parashihen në Projekt-buxhetin për vitin 2012, si dhe sqaroi parametrat tjerë që pasqyrohen në tabelat e paraqitura në këtë Projektligj.

Ministri, në fund i ftoi deputetët për miratim, në parim, të këtij Projektligji.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Hasime Krasniqi** tha se ky komision ka shqyrtuar, në parim, Projektbuxhetin për vitin 2011, dhe me shumicë votash i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë në parim dhe t'i krijojë mundësinë Komisionit të bëjë përmirësimet e mundshme në fazat e procedimit të mëtejshëm të Projekt-buxhetit.

Ajo, Projekt-buxhetin për vitin 2012, e vlerësoi si një dokument të përgatitur mirë në aspektin përmbajtësor dhe teknik, në të cilin janë të përfshirë treguesit makro ekonomikë që i paraprijnë hartimit të buxhetit dhe, në përgjithësi, kemi një material

të mjaftueshëm të detajizuar mirë, që i krijon mundësi secilit deputetë të bëjë analizat e nevojshme.

Më tej, ajo u fokusua në pjesët strukturore të këtij Projekt-buxheti, si dhe në pjesën e debatit që kanë pasur në Komisionin për Buxhet dhe Financa lidhur me Projekt-buxhetin për vitin 2012.

Në fund, ajo ftoi deputetët për miratim në parim të këtij Projektligji.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Adem Grabovci** vlerësoi përpjekjet e ministrit të Financave gjatë përpilimit të këtij Projektligji dhe punën e bërë me të gjitha grupet parlamentare të Kuvendit të Kosovës, me qëllim të harmonizimit të të gjitha kërkesave dhe që ky buxhet të dalë sa më i qartë dhe i kompletuar.

Më tej, ai tha se Kosova është shteti i vetëm në rajon i cili ka projektuar 40% të buxhetit të tërësishëm të jetë në investime kapitale, që është një dëshmi e mirë se ky buxhet është buxhet për zhvillim ekonomik të vendit.

Më pas, deputeti Grabovci u fokusua në disa nga elementet më të rëndësishme të këtij buxheti, të cilat janë vlerësuar dhe përkrahur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe organizmat tjerë financiar ndërkombëtar, të cilat janë: kontrolli ndaj buxhetit publik të trashëguar, borxhit publik, i cili aktualisht është më i vogli në regjion, harmonizimi i plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe, më e rëndësishmja e këtij buxheti, është se ka rritje buxhetore.

Grupi Parlamentar të PDK-së mbështet Projekt-buxhetin për vitin 2012 dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të tij.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Naser Osmani** tha se grupi që ai përfaqëson, ka analizuar me kujdes Projekt-buxhetin e vitit 2012 dhe konsideron që edhe ky buxhet është ndërtuar mbi bazën e paqëndrueshmërisë së të hyrave dhe janë planifikuar shpenzime që nuk reflektojnë nevojat e qytetarëve të Kosovës. Këto shpenzime nuk do të zvogëlojnë varfërinë dhe nuk do të krijojnë vende të punës dhe, si i tillë, nuk merr parasysh vërejtjet e shumë institucioneve ndërkombëtare dhe nuk tregon se si do të përmirësohet pozita financiare dhe ekonomike e Kosovës.

Më tej, ai tha se disa vërejtje të paraqitura nga Grupi Parlamentar i LDK-së, në muajin mars për Projektbuxhetin për vitin 2011, ishin të sakta.

Më pas, deputeti Osmani u fokusua në vlerësimet e Grupit Parlamentar të LDK-së lidhur me parametrat buxhetorë të këtij Projektligji, që kanë të bëjnë me të hyrat e planifikuara të grumbulluara në kufi prej 831 milionë €, ku së paku ¼ e këtyre mjeteve shkojnë për importe të lloj-lloj mallrave, duke nënvlerësuar kështu prodhimet vendore, rritjen e buxhetit për paga për 20 milion €, e jo për të rritur apo për të ruajtur fuqinë blerëse të pagave të tanishme, rritjen më të ngadalshme të buxhetit për mallra dhe shërbime se sa norma e inflacionit, investimet kapitale, autostrada e cila merr gjysmën e investimeve kapitale, për ndarje të ulët buxhetore për bujqësi etj.

Ai, në vazhdim tha se kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së do ta dorëzojë dokumentin alternativ lidhur me Projekt-buxhetin për vitin 2012.

Deputeti Osmani, më tutje bëri një elaborim të përmbajtjes së këtij dokumenti.

Ai, në fund kërkoi që të merren parasysh të gjitha ato sugjerime të cilat i ka dhënë Grupi Parlamentar i LDK-së lidhur me Projekt-buxhetin për vitin 2012.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, **Visar Ymeri** tha se ky dokument më së miri reflekton konceptin qeverisës të kësaj qeverie. Ky Projekt-buxhet po ashtu flet zëshëm për nivelin e njohjes dhe të kuptimit që kjo qeveri ka për interesat ekonomike e shoqërore të vendit.

Më tej, deputeti Ymeri foli rreth disa të metave dhe paqartësive këtij Projektligji, për të cilat tha se ende pa i parë numrat, e bëjnë projektligjin të çuditshëm dhe të rrezikshëm. Të tillë e përmendi nenin 11, i cili ia mundëson ministrit, qeverisë ose organizatave buxhetore të manipulojë me mjete, duke ua lejuar paradhënien deri në 15% të vlerës së përgjithshme të kontratës për ato kontrata që e tejkalojnë shumën prej 10 mijë eurosh, ndërkohë që Qeverisë ia lejon të aprovojë pagesa të paradhënies deri në 30% të vlerës së kontratës, madje 100% për mallra dhe shërbime vetëm me miratimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Pastaj, ai në këtë kontekst e përmendi edhe nenin 14 të Projektligjit, i cili paraqet mendësinë e keqplanifikimit, i cili praktikisht ia lejon lirinë e pafund Qeverisë që t'i ndryshojë projektet kapitale ashtu si të dojë gjatë ekzekutimit të buxhetit, gjë që e bën votimin e këtij buxheti në Kuvend vetëm sa për sy e faqe.

Ai, në vazhdim shtroi pyetjen se si është e mundur që në prill të këtij viti të na thuhet nga ana e Qeverisë se do të kemi rritje ekonomike prej 7 deri në 8 %, e në nëntor ta planifikojmë buxhetin duke supozuar rritje prej vetëm 5%.

Më pas, ai u fokusua edhe në aspekte tjera të Projektligjit për buxhetin e vitit 2012.

Në fund, theksoi se Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk do ta votojë këtë Projekt-buxhet të paraqitur nga Qeveria.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në fillim të fjalës tha se grupi parlamentar që ai përfaqëson mendon se ky buxhet është buxhet në rrjedhën e buxheteve që janë votuar në Kuvendin e Kosovës në katër vitet e fundit, e që ka sjellë varfërimin e vazhdueshëm të shtetit të Kosovës, futjen në borxh të shtetit të Kosovës dhe një jetë gjithnjë e më të pasigurt për qytetarët e Kosovës.

Më tej, ai tha se duke pasur parasysh që parashihet 5% rritje ekonomike për vitin e ardhshëm, në të njëjtën kohë parashihet 5% rritje e të hyrave buxhetore, shihet se Qeveria e ka lënë Kosovën të ecën vetë, domethënë Qeveria ka hequr dorë prej punës në luftimin e evazionit fiskal, sepse po të ndodhte e kundërta, me siguri të hyrat kishin për t'u rritur më shumë. Sikur Qeveria të kishte politika të qarta për luftimin e korrupsionit, me siguri se kjo do të ishte reflektuar te projektimi i të hyrave. Ai gjithashtu konstatoi se Qeveria ka hequr dorë prej krijimit të kushteve për investime të huaja, ka hequr dorë për të parashikuar ulje të papunësisë etj.

Në vazhdim, deputeti Gjini theksoi se përkundër faktit që thuhet se do të jenë diku investime kapitale afër 300 milionë euro, përpos autostradës, më shumë se gjysma e atyre projekteve janë bartje prej vitit të kaluar, çka do të thotë se në vitin e kaluar nuk janë realizuar projektet e premtuara.

Më pas, ai u fokusua edhe në aspekte tjera të Projektligjit për buxhetin e vitit 2012.

Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, **Myzejene Selmani**, fillimisht përshëndeti përfaqësuesin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, i pranishëm në sallë. Më pas, tha se është e drejtë demokratike e secilit deputet që të shprehë mendimin e vet, duke ditur se të gjitha paratë të cilat sot janë pasqyruar në Projektbuxhetin 2012, janë para të qytetarëve të Kosovës. Çdo sugjerim i mirë në këtë projektbuxhet, është në të mirë edhe të vetë ministrit të Financave, gatishmërinë e të cilit e vlerësoi edhe gjatë raportimit në grupet parlamentare.

Më tej, ajo theksoi se përkundër rrethanave në të cilat gjendemi ne dhe krizës në të cilën ndodhet e gjithë Evropa, është pozitive që ky projektbuxhet të jetë racional dhe të krijojë atë që është më e rëndësishme për Qeverinë dhe qytetarët, që të ndryshojë në të mirë jetën e tyre dhe mirëqenien e tyre.

Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re mbështet Projekt-buxhetin për vitin 2012, tha ajo.

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Sasha Milosavljeviq** tha se grupi parlamentar që ai përfaqëson ka shqyrtuar Projekt-buxhetin për vitin 2012, dhe jemi të vetëdijshëm se ky buxhet do të jetë jo i mjaftueshëm dhe, si i tillë, krijon mundësi të kufizuara për zhvillim. Në vazhdim, ai theksoi disa të meta të cilat e karakterizojnë këtë Projekt-buxhet, të cilat kanë të bëjnë me mosrritjen e buxhetit 2012 për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, investimet në shëndetësi, arsimin dhe sportin në komunat Graçanicë dhe Shtërpce. Si grup parlamentar e mbështesim Projektligjin për Buxhetin për vitin 2012, dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet parlamentare, theksoi deputeti Milosavljeviq.

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, **Duda Balje** tha se si grup parlamentar që ajo përfaqëson, Projektligjin për Buxhetin për vitin 2012 e vlerëson si një dokument të përgatitur mirë, dhe si i tillë shpie në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe eliminon dobësitë ekzistuese, me theks në fushën ekonomike.

Ajo, më tej u fokusua në parametrat buxhetorë, duke përmendur veçanërisht rritjen ekonomike prej 5%, të paraparë në këtë Projekt-buxhet, pastaj stabilitetin makro-fiskal i cili në kushtet aktuale të krizës financiare në rajon, ka një domethënie të veçantë.

Deputetja Duda Balje, në fund uroi ministrin e Financave për punën e bërë në këtë Projekt-buxhet dhe shfaqti gatishmërinë e Grupit Parlamentar “6+” për ta votuar Projektligjin për Buxhetin e vitit 2012.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: Ramiz Lladrovci, ministri Bedri Hamza, Sabri Hamiti, Liburn Aliu, kryeministri Hashim Thaçi, Time Kadrijaj, Aurora Bakalli, Kurtan Kajtazi, Hykmete Bajrami, Blerim Shala, Albana Fetoshi, Muhamet Mustafa, Goran Marinkoviq, Fikrim Damka, Bekim Haxhiu, Ali Sadriu, Albulena Haxhiu, Idriz Vehapi, Sali Morina, Xhevdet Neziraj, Anton Quni, Nait Hasani, Rexhep Selimi, Teuta Haxhiu, Fadil Demaku, Valbona Dibra, Emilija Rexhepi, Shaip Muja, Lirije Kajtazi, Agim Kuleta, Vjollca Krasniqi, Ramë Vataj, Glauk Konjufca, Vjosa Osmani, Hydajet Hyseni, Albin Kurti, Ismet Beqiri, Rita Hajzeraj-Beqaj, Ganimete Musliu, Afërdita Berisha – Shaqiri, Armend Zemaj, Arben Gashi, Haki Demolli, Sadri Ferati, Kimete Bytyçi, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Ndërsa, deputetët të cilët i paraqitën diskutimet e tyre me shkrim janë: Hashim Deshishku, Jeton Svirca, Hamza Balje, Bahri Thaçi, Latif Gashi, Hasime Krasniqi dhe Enis Kervan.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër-----35,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për mbeturinat

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në bazë të nenit 57.7 të Rregullores së Kuvendit ka kërkuar nga Kuvendi afat shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për mbeturinat.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutime, kryetari kërkoi nga Kuvendi që përmes një votimi formal me ngritje dore të deklarohen për kërkesën e lartpërmendur.

Kuvendi miratoi kërkesën e lartpërmendur të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i lejohej afatit shtesë, prej tridhjetë (30) ditësh, për shqyrtimin e Projektligjit për mbeturinat.

6. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët për propozimet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, për zëvendësimin e anëtarëve në Komisionet parlamentare.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputeti Liburn Aliu, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, emërohet anëtar i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të deputetes Aurora Bakalli.
2. Deputeti Glauk Konjufca, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, emërohet anëtar i Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, në vend të deputetit Agim Kuleta.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 19:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI